



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 100/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Infosoft Office” sh.p.k, me numër unik identifikues 810813742 dhe me seli në Prishtinë, Rr. “Tahir Zajmi”, kundër debitorit “Poly Print Internacional” L.L.C, me numër unik identifikues 811548645, me seli në Graçanicë, Magjistralja Prishtinë – Ferizaj, km 10, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 661/2022 e datës 23.12.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, jashtë seancës me datën 16.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Poly Print Internacional” L.L.C, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 661/2022 i datës 23.12.2022, i lejuar nga Përmbartues Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Infosoft Office” sh.p.k, me datë 23.12.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 661/2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturë nr. 48805 e datës 29.10.2021, Faturë nr. 48543 e datës 14.10.2021, Faturë nr. 48249 e datës 28.09.2021, Faturë nr. 50190 e datës 18.02.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,563.94 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor duke theksuar se lënda e cila është marrë nga pretenduesi këtu kreditori nuk është e atij lloji dhe e njëjta është prishur, për çka edhe kreditori është në dijeni.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka deklaruar se debitori në asnjë rast nuk ka kërkuar që mallrat që është furnizuar të kthehen apo të ketë njoftuar se ato mallra janë dëmtuar. Ka shtuar se përmes email-it debitori është njoftuar që detyrimi duhet të përfundohet brenda 30 ditëve, mirëpo i njëjti ka kërkuar kohë shtesë për të përfunduar obligimin e tij.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentet - faturat nr. 48805 e datës 29.10.2021, nr. 48543 e datës 14.10.2021, nr. 48249 e datës 28.09.2021, dhe nr. 50190 e datës 18.02.2022, të cilat i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përbarimit pasi që janë të përshtatshme për përbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit, mirëpo, gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tij, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 100/23, datë 16.11.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.